

### Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuese, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrim të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

### Aktivitetet përgjatë muajit Mars, 2022

#### Konferencë e përbashkët MD/KKKK – ANAC: Parandalimi i korrupsionit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

28.03.2022. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Agjencia Italiane Antikorrupsion (ANAC) organizuan në Tiranë një konferencë të përbashkët me fokus parandalimin e korrupsionit dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të fushës. Ministri i Drejtësisë, z. Manja dhe Presidenti i ANAC, z. Busia, bashkëdrejtuan këtë konferencë dhe referuan format e bashkëpunimit konkret dypalësh të strukturave antikorrupsion. Një vëmendje të veçantë në konferencë iu dha përdorimit të instrumenteve të auditimit të autoriteteve publike në përdorimin e fondeve publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit; kontrolli dhe siguri i procedurave të prokurimit publik nga Agjencia e Prokurimit Publik si dhe transparencës dhe garantimit të së drejtës së informimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Në përfundim të konferencës, u dhanë certifikata trajnimi për Koordinatorët e Rrjetit Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë.



Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://drejtesia.gov.al/lufta-kunder-korrupsionit-ministri-i-drejtesise-takon-presidentin-e-anac>

#### Fillon procesi i hartimit për Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion, 2023-2030

30.03.2022. Ministria e Drejtësisë fillon procesin e hartimit të strategjisë së re antikorrupsion. Nën drejtimin e zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Adea Pirideni, u mbledh grupi ministror i punës, në përbërje të cilin janë specialistë të drejtorive të ministrisë. Reforma e politikave antikorrupsion do të përfshijë hartimin dhe konceptimin e kuadrit të plotë strategjikë (strategji - plan veprimi - pasaportë të treguesve) me impakt forcimin dhe rritjen e performancës institucionale dhe ndërinstitucionale të fushës. Strategjia e re antikorrupsion, do të ketë një parashikim kohor zbatimi vitet 2023-2030, dhe do të ofrojë një ndërthurje të qasjes horizontale antikorrupsion me sektorë specifikë, që kanë rezultuar problematike dhe me perceptimin më të lartë të korrupsionit, siç janë: arsimit-shëndetësia-pronat-taksat e tatimet. Ministria e Drejtësisë do të asistohet në këtë proces nga grupi i ekspertizës teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë. Objektivet e strategjisë së re ndërsektoriale antikorrupsion do të jenë gjithashtu shtyllat e Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim të Integruar, komponenti demokracia dhe mirëqeverisja, që është aktualisht në proces hartimi nga Kryeministria.





#### Grupi Teknik Antikorrupsion miraton raportin e monitorimit të planit të veprimit antikorrupsion, 2021

29.03.2022. Përfaqësuesit Teknikë të Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit diskutuan dhe dakordësuan përmbajtjen e raportit vjetor 2021, të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, 2020-2023. Raporti i monitorimit jep një analizë të progresit të arritur në vitin 2021 të Strategjisë Antikorrupsion, dhe të problematikave që janë evidentuar gjatë zbatimit të planit të veprimit. Gjatë vitit 2021 kanë qenë për zbatim dhe nën monitorim 64 masa e 119 aktivitete, si dhe janë vlerësuar vlerat e synuara (targets) për 37 tregues performance të 18 objektivëve të Strategjisë. Rezultate të monitorimit janë: realizuar 37 masa/76 aktivitete nga 64 masa/119 aktivitete gjithsej për zbatim; janë realizuar plotësisht 18 tregues performance nga 37 gjithsej. Qasja parandaluese ka arritur një shkallë realizueshmërie 91.29% - qasja ndëshkuese ka arritur një shkallë realizueshmërie 31.25% dhe qasja ndërgjegjësuese ka arritur një shkallë realizueshmërie në masën 44.33%. Drafti final i raportit të monitorimit do të miratohet në mbledhjen e Komitetit Koordinator antikorrupsion në muajin prill dhe raporti do të bëhet publik në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në menu: <https://drejtesia.gov.al/raporte-monitorimi/>.



#### “Kurrikula antikorrupsion” në shkollat e mesme rrit njohuritë e nxënësve kundër korrupsionit

9-10.03.2022. Projekti “Kurrikula antikorrupsion” në shkollat e mesme të Tiranës vijon zbatimin edhe gjatë muajit mars 2022. Në 4 shkollat e mesme, “Petro N.Luarasi”, “Qemal Stafa”, “Asim Vokshi”, “Myslym Keta” nxënësit kanë vijuar takimet me ekspertët italianë të sjellë nga organizata italiane Avviso Pubblico, të cilët kanë promovuar kulturën e vendit të tyre në luftën kundër korrupsionit. Mekanizmat antikorrupsion, incentivimi i nxënësve kundër korrupsionit, angazhimi dhe bashkëpunimi i tyre dhe familjarëve kundër korrupsionit ishin kryefjala e takimeve dhe diskutimeve të zhvilluara në secilën prej 4 shkollave. Takimet në këtë fazë të projektit u zhvilluan online, dhe nxënësit diskutuan me ekspertët italianë se si ata mund të bashkëpunojnë kundër korrupsionit. Specialistë të antikorrupsionit pranë Ministrisë së Drejtësisë lehtësuan aktivizimin e nxënësve dhe për të asimiluar konceptet kryesore të fushës. Veprimtaritë në terren të projektit do të vijojnë në muajt në vijim dhe nxënësit do të promovojnë projektin e tyre antikorrupsion.



#### Ndërgjegjësim dhe “advocacy” kundër korrupsionit

1-31.03.2022. Gjatë muajit mars 2022, në rrugët e kryeqytetit ka filluar shfaqja e videove antikorrupsion. Promovimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion ka filluar në të gjithë ekranet publikë të vendosura në rrugët e Tiranës me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e “advokacisë” antikorrupsion për qytetarët që kërkojnë shërbime publike. Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë ka shpallur publikisht 17 video të animuara, me zë, dhe iu bënë thirrje qytetarëve dhe publikut të gjerë të refuzojnë korrupsionin dhe ta denoncojnë atë pranë koordinatort të Rrjetit Antikorrupsion. Koordinator antikorrupsion është bashkëpunëtori më i ngushtë në luftën kundër korrupsionit në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime për publikun. “Së bashku kundër korrupsionit!”



#### Ekspierencia të përbashkëta rajonale kundër korrupsionit

15 - 18.03.2022. Ekspertët e Drejtorisë Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë kanë ndarë me kolegë homologë të Bosnje-Hercegovinës eksperiencën e tyre të ndërgjegjësimit qytetar kundër korrupsionit. Një ekip ekspertësh dhe profesionistësh të fushës antikorrupsion nga Bosnja kanë zhvilluar në Tiranë takime dypalëshe në Ministrinë e Drejtësisë, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë dhe kanë ndarë eksperiencën e qasjes së publikut kundër korrupsionit. Fushatat e ndërgjegjësimit antikorrupsion të kryera në Shqipëri, dhe promovimi i aktiviteteve për publikun kanë patur interesin e kolegëve nga Bosnja që kanë dashur të diskutojnë këto elemente dhe krijimin e mundësive për t'i replikuar ato në vendin e tyre. Adaptimi i masave dhe programeve antikorrupsion me pjesëmarrje qytetare ka qënë pjesë e eksperiencës së ndarë.



#### Lobizmi dhe rregullimi i tij në vëmendje të specialistëve antikorrupsion dhe të politikave

15.03.2022. Specialistë të Drejtorisë Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë bashkë me kolegë të Kuvendit, të ministrive të linjës morën pjesë në webinarin me temë “Tendencat dhe sfidat në rregullimin e aktiviteteve të lobimit”. Ky aktivitet u zhvillua nga Rrjeti i Agjencive Parandaluese Antikorrupsion (NCPA), ku Ministria e Drejtësisë është anëtare dhe pjesë e Grupit Drejtues. Ky webinar është i pari aktivitet publik për vitin 2022 nga kjo organizatë. Panelistë të takimit, ekspertë të fushës antikorrupsion nga Greqia, Serbia, Kanada dhe Kuebec, anëtarë të NCPA ndanë eksperiencat e tyre, mësimet dhe praktikat më të mira për lobizmin. Pjesë e posaçme e takimit ishte edhe sesioni i pyetjeve dhe përgjigjeve nga pjesëmarrësit. Lobizmi (lobbying) dhe rregullimi i tij është një prej rekomandimeve të dhëna nga GRECO në raundin e V të vlerësimit për Shqipërinë dhe për të cilën Shqipëria duhet të marrë masa për rregullimin e tij.

